

# Perspektivat Komunitare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm

Forcimi i faktorëve vendorë të qëndresës sociale

Engjellushe Morina, Beatrix Austin, Tim Jan Roetman dhe Veronique Dudouet

Dokument politikash 9, Fondacioni Berghof

Qershor 2019

## Për ÇFARË shërben dokumenti i politikave?

Dokumenti i politikave parashtron rekomandime për përmirësimin e programimit, me qëllim parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (PEDH) dhe thekson nevojën që të gjitha programimet të mbështeten në analiza dhe planifikim në nivel vendor. Ai vë në dukje edhe një sërë faktorësh dhe aktorësh që mund të kontribuojnë në qëndresën sociale kundër ekstremizmit të dhunshëm. Dokumenti mbështetet kryesisht te raporti i zgjeruar *Perspektivat Komunitare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm Mësimet e Nxjerra nga Ballkani Perëndimor*, i cili sapo përmbylli një projekt dyvjeçar mbi hulumtimin, dialogun me komunitetin dhe këshillimin për politikën në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

## PËRSE tema është e rëndësishme?

Trajtimi i ekstremizmit të dhunshëm (EDH) është kthyer në kuadrin qendror të analizës dhe politikëbërjes në shumicën e agjencive qeveritare perëndimore dhe joperëndimore. Për më tepër, kjo temë po formëson në masë edhe programimin e agjencive joqeveritare dhe instituteve kërkimore. Teksa nevoja për ta adresuar këtë fenomen është e pamohueshme, shpesh analizimi dhe programimi nuk arrijnë t'i kuptojnë dhe trajtojnë shkaqet, faktorët, aktorët dhe dinamikën kryesore sistematike. Shumica e ndërhyrjeve në fushën e Luftës kundër/Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm (LK/PEDH) janë fokusuar te qasjet e sigurisë nga lart-poshtë, që mundësojnë pjesëmarrje të pakët të komunitetit.

## Për KË është i rëndësishëm?

Dokumenti i politikave synon të depërtojë te politikëbërësit dhe përcaktuesit e axhendave në nivelin e komunitetit vendor, nivel kombëtar qeveritar dhe nivel ndërkombëtar.

Ai paraqet interes edhe për studiuesit dhe studentët e interesuar në fushën e ekstremizmit të dhunshëm, radikalizimit, parandalimit të dhunës dhe të interesuarit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

## PËRFUNDIME/REKOMANDIME

Të parit e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm përmes lenteve të vendosjes së paqes nënkupton nevojën për të investuar në instrumentet e analizimit të konflikteve sistematike, të projektuara posaçërisht për këtë fenomen dhe shfaqjet e tij të kontekstualizuara në nivel vendor. Nga ky studim, dolën në pah rekomandimet e mëposhtme, për programimin me qëllim parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në rajon dhe më gjerë:

- ≡ Forcimi dhe rritja e bashkëpunimit midis drejtuesve dhe aktorëve komunitarë, që luajnë rol të rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, me bashkinë (apo administratën vendore), përmes ngritjes së komiteteve të marrëdhënieve me komunitetin.
- ≡ Përfshirja e përfaqësuesve të aktorëve në nivel vendor dhe drejtuesve të komunitetit në analizimin e gjendjes së cënueshmërisë dhe qëndresës së komunitetit, si dhe në vendosjen e prioriteteve për politikën. Formulimi dhe hartimi në bashkëpunim i objektivave të reja dhe përsosja e atyre ekzistuese në përgjigje të kontekstit aktual.
- ≡ Përmirësimi dhe forcimi i performancës institucionale dhe politikëbërjes bashkëpunuese në fushat e arsimit, rinisë dhe çështjeve sociale.
- ≡ Njohja e institucioneve dhe drejtuesve fetarë në nivel vendor dhe qendror si aktorë me ndikim dhe me lidhje të ngushta me komunitetet e tyre përkatëse, në

mënyrë që të sigurohet angazhimi i tyre në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që prej fillimit.

≡ Investimi në identifikimin dhe forcimin e fak-

torëve të qëndresës së komunitetit dhe kohezionit social (si zhvillimi gjithëpërfshirës socio-ekonomik, toleranca ndërfetare dhe edukimi qytetar), si dhe në masat frenuese-frikësuese dhe ndëshkuese.

## Përmbajtja

- 1 Hyrje
- 2 Sfondi
- 3 Gjetjet
- 4 Përfundime dhe Rekomandime

# 1 Hyrje

Teksa vëmendja e ndërkombëtarëve është kthyer sërish nga rajoni i Ballkanit, vendosjes së paqes në rajon po i kushtohet gjithnjë e më tepër rëndësi. Kjo është një mundësi për ta lidhur vendosjen e paqes me një prej temave më të rëndësishme të axhendës ndërkombëtare: ekstremizmin e dhunshëm.

Në fillim të viteve 2010, vendet e Ballkanit Perëndimor shiheshin si eksportuesit më të mëdhenj për frymë në Evropë të vullnetarëve që luftonin për organizatat e armatosura selefiste-xhihadiste si ISIS dhe Jabhat Fatah al-Sham (e njohur më parë si Jabhal al-Nusra) (Shtuni 2016,2). Megjithatë, arsyet se përse disa komunitete janë më të cënueshme se disa të tjera ndaj thirrjes së grupeve të lidhura me ISIS dhe Al-Kaedën në një rajon që nuk shquhet si i prirur ndaj tendencave ekstremiste fetare krahasuar me vende konservatore si Arabia Saudite, nuk janë studiuar mjaftueshëm. Është e nevojshme të dallohet miti dhe stigma nga vëzhgimet e shëndosha. Megjithëse numri aktual i luftëtarëve të huaj është ulur që prej vitit 2016, vendet dhe komunitetet e rajonit po përballen me një sfidë të re, pasi ata që u larguan dhe fëmijët e tyre të ardhur në jetë jashtë vendit, po kthehen.

Aktorët vendore dhe rajonale të interesit, si dhe komunitetet e prekura po mundohen të gjejnë përgjigje efikase dhe masa parandaluese për ta trajtuar këtë fenomen. Kështu, vërehet nevoja e zhvillimit të programeve gjithëpërfshirëse dhe me objektiva të qarta, që të mund të ndihmojnë në krijimin e vendeve dhe komuniteteve të qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Në këtë kontekst, Fondacioni Berghof, së bashku me partnerët vendorë, kërkon të kuptojë se çfarë i bën disa komunitete të specifike të qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm, ndërkohë që disa komunitete të tjera, pavarësisht konteksteve të ngjashme socio-ekonomike, ideologjike dhe politike, paraqesin një nivel më të ulët qëndrese (Morina et al. 2019).

Ky dokument politikash thekson gjetjet kryesore të studimit, i cili nga ana tjetër u bazua në një projekt kërkimor dhe dialogimi dyvjeçar, i financuar nga Zyra Federale Gjermane e Punëve të Jashtme dhe i zbatuar së bashku me institutet kërkimore vendore në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut nga viti 2017 deri në vitin 2019.

Projekti në këto vende ndërthuri hulumtimin krahasues me shkëmbimet ndër-rajonale dhe vendore, të orientuara në praktikë. Veprimtaritë e angazhimit dhe dialogimit në nivel vendor, të organizuara me palët e interesit, komunitetet e prekura dhe autoritetet publike synonin të zhvillonin dhe forconin rrugët bashkëpunuese për përmirësimin e programimit për PEDH në nivel vendor, kombëtar dhe rajonal. Shpërndarja në rang ndërkombëtar advokon më tej përvetësimin e këtyre perceptimeve kyçe.

## 2 Sfondi dhe metodologjia

Të katër vendet e Ballkanit, pra Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, të marra nën shqyrtim, kanë mjaft ngjashmëri jo vetëm për shkak të pakënaqësive të përbashkëta historike, por edhe për shkak të ekonomive me efikasitet të ulët, keqfunksionimit administrativ, tensioneve kombëtare dhe etnike, si dhe çështjeve të pazgjidhura të identitetit. Në tre prej katër rasteve tona, tabloja plotësohet me proceset e papërfunduara të vendosjes së paqes dhe pajtimit.

Studimi ku mbështetet ky dokument politikash është kryer në nivel meso, pra duke gjetur të mesmen e artë midis faktorëve individualë kaq shumë të studiuar shtytës dhe tërheqës në nivel mikro dhe shkaqeve strukturore në nivel makro, si për shembull represionin shtetëror, privimi, varfëria dhe globalizimi. Ai synon të identifikojë faktorët e cënueshmërisë dhe qëndrësës së komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm, si dhe të hartojë dhe testojë rekomandimet e nxjerra nga vendosja e paqes nga poshtë-lart për parandalimin efikas të ekstremizmit të dhunshëm.

*Tabela 1: Komunitetet/Bashkitë e Prekura dhe të Paprekura të Përzgjedhura/Bashkitë sipas Shteteve*

Vendi	Bashkitë e Prekura	Bashkitë e PaPrekura
Shqipëria	Tirana (tre lagje)	Kavaja (“relativisht e paprekur”) Korça (“relativisht e paprekur”; por me risk potencial më të madh)
Bosnjë-Hercegovina	Kantoni Zenica-Dobojës (ZDC) Kantoni Sarajevës (SC)	Kantoni i Podrinjës Boshnjake (BPC)
Kosova	Hani i Elezit Mitrovica (nuk është studiuar në thellësi)	Deçani
Maqedonia	Çair (Shkup)	Struga (“relativisht e prekur”) Gostivari (“mesatarisht i prekur”)

Për të identifikuar dhe kuptuar se çfarë i bën komunitetet të qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm, studiuesit analizuan karakteristikat e komuniteteve në një kontekst të caktuar socio-ekonomik, ideologjik dhe politik. Komunitetet e prekura dhe të paprekura ishin “objektivi” kryesor i studimit (shihni Tabelën 1), i cili synonte të eksploronte dhe identifikonte se çfarë e bënte një komunitet të caktuar t’i parandalonte apo t’i bënte ballë (“rastësisht”, apo “qëllimisht”) kërcënimeve të ekstremizmit të dhunshëm, apo të mos ndikohej nga format ideologjike dhe/ose fizike të ekstremizmit të dhunshëm. Treguesi kryesor që u përdor për të përcaktuar nëse komuniteti ishte i prekur apo jo ishte numri i luftëtarëve të huaj për frymë (individë të larguar nga komuniteti drejt Sirisë dhe Irakut). Treguesi dytësor ishte numri i rekrutuesve dhe predikuesve të ndjekur penalisht.

Ky studim dallon prej të tjerëve falë disa veçorive: (1) është gjithëpërfshirës dhe i orientuar nga vepri, pasi komunitetet e studiuar u ftuan të angazhoheshin në një dialog mbi gjetjet dhe rekomandimet, dhe të identifikonin pikat hyrëse për zbatimin e tyre.

(2) fokusohet te perceptimet subjektive të komuniteteve të përftuara përmes intervistave dhe fokus grupeve me përfaqësues nga një grup i vetëm apo grupe të përziera (fetarë ose jofetarë, gjini të përziera, të rinj, drejtues të qeverive vendore dhe shoqërisë civile etj.).

Shumë shpejt, u arrit në përfundimin se komunitetet nuk janë as plotësisht të prekura dhe as plotësisht të paprekura, pasi një komunitet i paprekur mund të ketë disa.

## Rreth terminologjisë

Terminologjia e përdorur në këtë dokument politikash shquhet kryesisht për faktin se është e paqartë për shumicën dhe që shpesh, kritikohet si e politizuar, e koduar apo e zhargonizuar. Prandaj, ne dëshirojmë që të ndajmë me lexuesin kuptimin e këtyre termave që përdoren gjerësisht në këtë dokument:

**Radikalizim** | Procesi i ndryshimeve ideologjike dhe/ose të sjelljes që vijnë gjithnjë në rritje, dhe që sjell përfaqimin e botëkuptimeve dhe veprimeve më ekstreme dhe me shumë gjasa më të dhunshme.

**Ekstremizmi (i dhunshëm)** | Çdo ideologji që bie ndesh me vlerat dhe parimet bazë të një shoqërie. Shumë individë bëjnë dallimin midis ekstremizmit politik dhe atij fetar. Megjithëse nuk është thënë që ekstremistët ta përdorin dhunën me patjetër, togfjalëshi “ekstremizëm i dhunshëm” përdoret në kontekste ku botëkuptimet ekstremiste shoqërohen me justifikimin dhe përdorimin e dhunës ekstreme (si krimet barbare) kundër atyre që nuk ndajnë të njëjtin besim apo ideologji. Individët apo grupet mund ta shprehin ekstremizmin e dhunshëm përmes fjalimeve apo postimeve në media, duke kryer akte të izoluar dhune në emër të ideologjive ekstremiste, ose duke iu bashkuar fizikisht grupeve të dhunshme.

**Radikalizimi kumulativ/reciprok** | Termat ekstremizëm “kumulativ” dhe “reciprok” shprehin idenë se polarizimi aktual politik nuk ndodh në vakum, por shpesh vjen si përgjigje ndaj veprimeve apo fjalimeve të një grupi tjetër, si për shembull të grupeve nacionaliste të djathta. Kjo ka shumë rëndësi për ato debate publike që janë të prirura ta konsiderojnë radikalizimin dhe ekstremizmin si karakteristika të qenësishme të një feje të caktuar (zakonisht të Islamit).

**Qëndresa (Paprekshmëria)** | Qëndresa nënkupton që disa aktorë të interesit në komunitet janë të vetëdijshëm dhe ndërmarrin veprime të përbashkëta me qëllim luftën ndaj një fenomeni të caktuar. Kjo përfshin edhe qasjen e komunitetit ndaj këtij fenomeni dhe reagimin e tij në prag të një emergjence të lidhur me veprimtarinë e ekstremizmit të dhunshëm, apo edhe kur perceptohet se ky fenomen mund të sjellë shfaqjen e tij. Qëndresa nuk është kurrsesi absolute, por karakteristike sistematike dhe e ndryshueshme.<sup>1</sup>

**Cënueshmëria (Prekshmëria)** | Komuniteti i prekur është një komunitet që është ndikuar tashmë nga format ideologjike dhe/ose fizike të ekstremizmit të dhunshëm si: depërtimi i ideologjisë radikale, akte dhune të motivuara ideologjikisht, dukuria e luftëtarëve të huaj që vijnë nga ai komunitet dhe prania e aktorëve që “kultivojnë” cënueshmëri ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

*Për diskutime më të zgjeruara, shihni Aroua 2018 dhe Morina et al. 2019.*

## 3 Gjetjet

### Faktorët e Cënueshmërisë apo Qëndresës së Komunitetit ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm

Në të gjitha rastet e komuniteteve të prekura në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoni vërehen disa faktorë dhe aktorë që i formësojnë ato. Faktori kryesor është polarizimi i thellë shoqëror, qoftë social, politik, etno-politik apo fetar. Ky faktor pasohet nga shkalla e lartë e mosbesimit në institucionet politike dhe fetare, që shihen kryesisht si të papërgjigjshme, të paefektshme dhe të njëanshme. Për sa i

<sup>1</sup> Për më tepër, studiuesit ranë dakord të bënin dallimin midis komuniteteve të prekura dhe atyre të paprekura. Kjo terminologji është përzgjedhur në mënyrë që të mos hamendësohej se komunitetet që shfaqnin simptoma të ekstremizmit të dhunshëm janë automatikisht të cënueshme, apo se komunitetet që nuk shfaqin asnjë simptomë të ekstremizmit të dhunshëm (së jashtëmi) janë automatikisht të qëndrueshme. Me komunitet të paprekur kuptohet një komunitet që nuk shfaq shenja të dukshme radikalizimi apo ekstremizmi të dhunshëm.

përket këtyre dy aspekteve, Shqipëria duket se është më e veçuar, pasi autoritetet fetare dhe ndasitë etno-politike kanë qenë historikisht më pak të theksuara. Siç pritej, kushtet socio-ekonomike nuk ishin faktorë vendimtarë në vetvete, megjithëse në disa raste luanin njëfarë roli në krijimin e një mjedisi më favorizues. Për më tepër, cilësia e ulët e edukimit fetar dhe nevoja për të forcuar të menduarit kritik theksohen në të katër vendet si fusha që duhen përmirësuar urgjentisht. Së fundmi, studimet në rang kombëtar nxjerrin në pah ndikimin e madh që ndjenja e theksuar e marginalizimit (qoftë në bazë të përkatësisë minoritare, apo përkatësisë në një zonë të lënë pas dore politikisht/ekonomikisht) ka në predispozitën e komunitetit për të rënë pre e rekrutimit, radikalizimit dhe prekshmërisë nga ekstremizmi i dhunshëm.

Për sa i përket aktorëve, ose veprimeve të këtyre aktorëve, që janë edhe më të rëndësishme se vetë aktorët, mund të arrijmë në përfundimin domethënës se në komunitetet e prekura mbizotëron ndjesia se nuk ekziston asnjë aleancë proaktive dhe e bashkuar aktorësh (qeveria vendore dhe/ose institucione fetare). Në vend të kësaj, ekziston një hapësirë boshe dhe e pambrojtur në të cilën mund të depërtojnë edhe rekrutuesit më ekzogjenë dhe ku mund të krijojnë mjedise të parregulluara për predikim dhe prozelitizim. Drejtues komunitarë si mësuesit, prindërit etj., shpesh përshkruhen ose si tejet të pavetëdijshëm për problemin, ose si të paimësuar (në disa raste, prindërit mund edhe t'i kenë miratuar veprimet e fëmijëve të tyre në moshë të re, ndonjëherë edhe të pavetëdijshëm për pasojat). Megjithatë, situata nuk është vetëm bardh e zi.

Këtë e pasqyron më së miri edhe rasti studimor i Shqipërisë: “Prekshmëria nuk përcaktohet vetëm nga prania e faktorëve apo aktorëve që nxisin çënueshmëri ndaj EDH-së, por më tepër nga niveli, dinamika dhe ndërveprimi i faktorëve dhe aktorëve brenda një komuniteti të caktuar” (Qirjazi/Shehu 2018, 1). Kështu, komunitetet e prekura duhen parë pa një vijimësi të qartë (pra pa linearitet, çka do të thotë se nuk ka linja apo pikënisje të qarta). Në vend të kësaj, ne shohim aty një sistem kompleks dhe të paqartë, i cili mund të shfrytëzohet në mënyrë më të suksesshme nga disa aktorë kur kushtet janë të favorshme.

Prandaj, duhet treguar kujdes i madh në vlerësimin e çënueshmërisë (ose qëndrësës) së qenësishme të komuniteteve, pasi këto mund të luhaten dhe të ndryshojnë me ritme të shpejta.

Në rastin e komuniteteve të paprekura, ne na intereson dallueshmëria sociale e disa bashkive në Ballkanin Perëndimor, të cilat në dukje nuk janë të prekura nga ekstremizmi i dhunshëm pavarësisht se ofrojnë “mjedise favorizuese”, si për shembull për sa i përket kushteve mbizotëruese socio-ekonomike, të cilat mund t'i kthejnë këto komunitete në pre të lehta për rekrutuesit.

Bazuar në gjetjet empirike, mund të arrihet në përfundimin se këto gjashtë komunitete përfituan nga konteksti i favorshëm që forconte qëndrësën e tyre kundër kërcënimeve të jashtme dhe nga kapaciteti i lidershit të demonstruar nga aktorët shtetërore, fetarë dhe të shoqërisë civile. Disa prej faktorëve kyçë të identifikuar si kushte të favorshme për paprekshmërinë përfshijnë rolin e harmonisë së perceptuar sociale dhe shumëkulturalizmin, ndjesinë gjithëpërfshirëse të identitetit kombëtar, që i mban qytetarët të bashkuar dhe duke refuzuar thirrjen e ideologjive neo-fundamentaliste (si selefizmi), si dhe historia dhe gjeografia e veçantë e këtyre bashkive.

Hulumtimi ynë tregoi se aktoret veprues kanë shumë rëndësi, duke filluar që nga roli i edukatorëve dhe mësuesve, të cilët i pajisin të rinjtë me të menduarit kritik, vetëbesim dhe njohuri teologjike; te OSHC-të, që nxisin angazhimin qytetar të pjesëtarëve të komunitetit; dhe së fundi, autoritetet fetare dhe institucionale që ndërmarrin veprime të koordinuara dhe kohezive. Komunitetet e paprekura drejtohen nga imamët dhe kryebashkiakët, të cilët i mbikëqyrin nga afër zonat e tyre për të monitoruar “pulsin” e komunitetit; ndërmarrin nisma për të nxitur tolerancën dhe interpretimet progresive të teksteve fetare për të parandaluar ligjërimet ekstremiste; marrin masa proaktive për të kontrolluar përhapjen e ideve ekstremiste duke parandaluar rrënjosjen e influencave ekzogjene dhe armiqësore në komunitet, ose duke reaguar negativisht ndaj fjalimeve të urrejtjes që mund të rrisin çënueshmërinë e komuniteteve.

Megjithatë, në rastin e komuniteteve të prekura, provat nuk mjaftojnë për t'i klasifikuar këto komunitete të paprekura, si plotësisht apo vendosmërisht të qëndrueshme ndaj kërcënimit të ekstremizmit të dhunshëm. Gjatë eksplorimit të kompleksitetit të zbatimit të konceptit të qëndrësës së komunitetit në studimin e ekstremizmit të dhunshëm, hulumtimi konstatoi në të gjitha rastet studimore të vendeve nën

studim se ndërgjegjësimi, veprimi dhe qasja e drejtuesve vendorë kontribuojnë të gjitha së bashku pozitivisht në qëndresën e komunitetit.

Pra, për ta përmbledhur, nga krahasimi i karakteristikave të cënueshmërisë dhe qëndresës së komuniteteve në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut u arritën gjetjet kyçe të mëposhtme:

- ≡ Polarizimi, keqfunksionimi i institucioneve, marginalizimi i perceptuar i komuniteteve bazuar në identitetin e tyre dhe specifikat gjeografike dhe historike janë faktorët kryesorë që favorizojnë lindjen e ekstremizmit të dhunshëm.
- ≡ Si aktorët vendorë, edhe ato ekzogjenë, si p.sh aktorët joshtetërorë fetarë, dhe ekstremizmi reciprok luajnë rol mundësues kyç.
- ≡ Komunitetet e paprekura mund të jenë të qëndrueshme ose rastësisht (faktorë socialë dhe historikë) ose qëllimisht (udhëheqje komunitare proaktive/reaguese).
- ≡ Ndërgjegjësimi për rreziqet, qasja e tolerancës ndaj të tjerëve dhe veprimi për parandalim proaktiv konsiderohen si tre përbërësit kryesorë të parandalimit efikas të ekstremizmit të dhunshëm në komunitete..

### **Nga PEDH te Vendosja e Paqes: Përgjigjet e politikave**

Studimi vlerësoi edhe rëndësinë dhe përshtatshmërinë e përgjigjeve të politikave kombëtare dhe ndërkombëtare në formën e programeve për PEDH. Ndryshe nga programet e fokusuara ngushtësisht në siguri dhe të orientuara drejt përdorimit të fuqisë ekonomiko-ushtarake në luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm (EDH), programet që synojnë parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm theksojnë më tepër adresimin e faktorëve të ndryshëm politikë dhe sociologjikë si për shembull identifikimin dhe trajtimin e faktorëve shtytës dhe tërheqës, adresimin e shkaqeve kryesore strukturore dhe forcimin e qëndresës në nivel individual dhe komunitar (Austin/Giessmann 2018, iv).

Studiuesit tanë vendorë zbuluan se në shumë raste, perceptimet e komunitetit ndaj programeve për PEDH-në janë tejet të fragmentuara. Komunitetet konsultohen apo informohen shumë rrallë për planet kombëtare. Për më tepër, në rastin e Kosovës, studiuesit gjetën se kishte një mospërputhje midis faktorëve të identifikuar të qëndresës (për shembull marrëdhënie të forta bashkëpunimi midis aktorëve vendorë fetarë dhe politikë) dhe natyrës së veprimtarive të PEDH (kryesisht ndërgjegjësimi dhe gjenerimi i të ardhurave). Së fundi, vërehet mungesë kapacitetesh dhe burimesh në fushat e arsimit (laik dhe fetar), punës sociale apo krijimit të hapësirave qytetare.

Ne propozojmë që qasja e vendosjes së paqes në kontekstin e PEDH të jetë me të vërtetë e dobishme, pavarësisht pengesave që mund të hasen. Studimi ynë gjeti se, nga njëra anë, veprimtaritë e vendosjes së paqes pas luftës (të përkufizuara si veprimtari për dialog dhe pajtim ndërkombëtar) shihen si të paefektshme nga një numër i konsiderueshëm njerëzish në Bosnjë dhe Hercegovinë. Jo të gjitha pritshmëritë normative (si për shembull, që vendosja e paqes të adresojë shkaqet kryesore strukturore dhe individuale në mënyrë më të gjithanshme) janë bërë realitet në “terren” në Ballkanin Perëndimor. Në disa raste, nismat e vendosjes së paqes dhe pajtimit kanë qenë subjekt shfrytëzimi dhe manipulimi politik (shihni për shembull Turcalo/Veljan 2018, 21). Ndaj, shpesh, popujt i shikojnë këto nisma me shumë cinizëm dhe pesimizëm.

Nga ana tjetër, studimi ynë nënvizon se, ato që dikush mund t'i quajë si esenca e vendosjes së paqes, kontribuojnë me të vërtetë në qëndresë: mbledhjet ndëretnike, dialogu ndërfetar, toleranca fetare dhe shumëkulturalizmi, lidhjet dhe marrëdhëniet aktive midis identiteteve të grupeve në një komunitet, forcimi i identiteteve shumëdimensionale dhe gjithëpërfshirëse dalin në pah si faktorë të rëndësishëm që kontribuojnë në qëndresë.

Siç vihet në dukje edhe nga autorët e rastit studimor të Maqedonisë së Veriut: “Në Gostivar dhe Strugë ka pasur përpjekje të dukshme për promovimin e shumëkulturalizmit, diversitetit dhe vlerave të shoqërisë ndëretnike. Të anketuarit sugjeruan që anëtarët e këtyre bashkive të informoheshin mirë për vlerat e diversitetit. Për më tepër, në Strugë vërehen përpjekje të bashkërenduara për zhvillimin dhe promovimin e veprimtarive dhe programeve që nxisin integrimin dhe bashkëpunimin ndëretnik, duke forcuar më tej qëndresën komunitare ndaj faktorëve që kontribuojnë në një mjedis që mundëson ekstremizmin”. (Stojkovski/Kalajdziovski 2018, 27).

## 4 Përfundime dhe Rekomandime

Programimi i suksesshëm për PEDH-në kërkon kontekstualizim dhe nuk mund të zbatohet sipas një plani “standard” të hedhur në letër. Prandaj, rekomandimet e përzgjedhura më poshtë (shihni Morina et al. 2019, 61ff. për një panoramë më të përgjithshme) bazohen në rekomandimet e dhëna për çdo rast studimor të secilit prej katër vendeve, pa zëvendësuar kurrsesi vlerësimet dhe sugjerimet e tyre të pavarura dhe të kontekstualizuara. Megjithatë, ato vënë në dukje perceptimet që konsiderohen si tejet të rëndësishme për shumicën e rasteve studimore të vendeve. Ne mendojmë se të gjitha këto duhen adresuar, në mënyrë të kontekstualizuar, në të gjitha ato mjedise ku synohet parandalimi i radikalizimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Rekomandimet ndahen në dy seksione: forcimi i faktorëve dhe aktorëve që favorizojnë qëndresën e komunitetit dhe zhvillimi i programeve të forta dhe efikase për PEDH-në.

Këndvështrimi komunitar në nivel meso rezultoi jo vetëm i ri, por edhe i rëndësishëm për studiuesit. Ne rekomandojmë përdorimin e tij në masë, si për shembull duke u fokusuar te roli i komuniteteve në rintegrimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe të familjeve të tyre. Nevojiten më tepër investime për të kuptuar më mirë dinamikat e ekstremizmit kumulativ, ngjashmëritë dhe ndryshimet midis nxitësve të konfliktit dhe nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe vlerësime sistematike të efektshmërisë së programimit për PEDH. Së fundi, vështrimi i parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm përmes lenteve të vendosjes së paqes nënkupton edhe nevojën për të investuar në instrumentet e analizimit të konflikteve sistematike, të projektuara në mënyrë të personalizuar për ekstremizmin e dhunshëm.

### Forcimi i faktorëve dhe aktorëve që fuqizojnë qëndresën e komunitetit

#### Institucionet vendore

- ≡ *Forcimi dhe rritja e bashkëpunimit midis drejtuesve dhe aktorëve të komunitetit të cilët mund të luajnë rol aktiv në PEDH. Bashkia (ose administrata vendore) duhet të drejtojë ngritjen e komiteteve për marrëdhëniet me komunitetin për të ofruar hapësira për diskutime të rregullta që përfshijnë grupe të ndryshme komuniteti. Kjo nismë mund të mbledhë së bashku palë të ndryshme interesi (gra, fëmijë, përfaqësues të të rinjve dhe grupeve etnike, grupeve fetare etj.) për të identifikuar shenjat e hershme të radikalizimit apo rekrutimit në grupe ekstremiste të dhunshme dhe të lejojë ndërmarrjen e veprimeve që në fazë të hershme.*
- ≡ *Fuqizimi i programeve ekzistuese që forcojnë vlerat qytetare dhe identitetin qytetar midis anëtarëve të komunitetit. Prezantimi dhe zbatimi i programeve që rrisin kohezionin social. Kjo do t'i ndërgjegjësojë pjesëtarët e komunitetit mbi identitetin e përbashkët dhe perceptimet e ndryshme për çështjet sociale. Projektimi i programeve, të cilat duhen përshtatur me nevojat e komunitetit, duhen drejtuar nga bashkia dhe administrata vendore, në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe përfaqësuesit e shoqatave të mësuesve dhe prindërve.*

#### Qeveritë dhe aktorët kombëtarë të interesit

- ≡ *Përfshirja e përfaqësuesve të aktorëve në nivel vendor dhe drejtuesve të komunitetit në analizimin e gjendjes së cënueshmërisë dhe qëndresës së komunitetit, si dhe në vendosjen e prioritetëve të politikave. Në këtë mënyrë, perspektivat komunitare mund ta informojnë zhvillimin e politikës që në fazat e hershme, si dhe të sigurojnë ndërgjegjësim në nivel vendor rreth masave të politikës në nivel qeveritar kombëtar.*
- ≡ *Njohja e institucioneve dhe drejtuesve fetarë në nivel vendor dhe qendror si aktorë me ndikim dhe me lidhje të ngushta me komunitetet e tyre përkatëse Sigurimi i angazhimit të tyre që në fazat e hershme për vlerësimin e rreziqeve dhe veprimin ndaj ekstremizmit të dhunshëm, në vend që të përfshihen në faza të mëvonshme për zbatimin e masave të krijuara pa sugjerimet e tyre. Aktorët fetarë mund të ndihen sikur janë përdorur thjesht si mjete dhe përfshirja e tyre do të shërbente si kundërpeshë ndaj kësaj ndjesie.*

### Donatorët, OJF-të dhe agjencitë qeveritare ndërkombëtare

- ≡ *Investime në identifikimin dhe forcimin e faktorëve të qëndresës së komunitetit dhe kohezionit social* (si zhvillimi gjithëpërfshirës socio-ekonomik, toleranca fetare dhe edukimi qytetar), si dhe në masat frenuese-frikësuese dhe ndëshkuese.
- ≡ *Krijimi dhe hartimi, në bashkëpunim, i objektivave të reja të ndërhyrjes dhe përsosja e atyre ekzistuese së bashku me përfaqësuesit e komunitetit vendor për të fuqizuar kapacitetin institucional dhe bashkëpunimin e aktorëve të interesit (fetarë dhe qeveritarë), si në nivelin e politikëbërjes kombëtare, ashtu edhe në nivel komuniteti, për të përmirësuar komunikimin, koordinimin dhe bashkëpunimin. Sigurimi i përfshirjes së përfaqësuesve të grupeve të ndryshme të komunitetit (përfaqësues fetarë, të të rinjve, grave).*

## Zhvillimi i programeve të forta dhe efikase për PEDH

### Institucionet vendore

- ≡ *Ndarja me të tjerët e mësimëve të nxjerra dhe praktikave të mira me palët e interesit. Si hap i parë, mund të shërbejë mbledhja e aktorëve të komunitetit për të diskutuar mënyrat e adresimit të radikalizimit, që sjellin ekstremizëm të dhunshëm dhe arritja e një perceptimi të përbashkët për fenomenin në lidhje me një komunitet të caktuar. Kjo ndarje informacioni mund të hapë rrugën drejt rritjes së vlerësimeve, ndërgjegjësimit dhe veprimeve të përbashkëta.*
- ≡ *Marrja në konsideratë e kohës së nevojshme për krijimin e besimit dhe marrëdhënieve, veçanërisht me grupet sociale që përjetojnë stigmatizim. Ndërgjegjësimi i agjencive kombëtare dhe ndërkombëtare rreth kësaj nevoje.*

### Qeveritë dhe palët kombëtare të interesit

- ≡ *Analizimi dhe angazhimi me komunitetet e prekura, ashtu edhe ato të paprekura, duke pranuar faktin se dy kategoritë nuk janë të ndara me thikë. Ky angazhim “krah për krah” mund të fillojë me krijimin e hapësirave bashkëpunuese për të mësuar me njëri-tjetrin. Komitetet për marrëdhëniet me komunitetin brenda bashkive mund të shërbejnë si mjedise të sigurta për këto shkëmbime. Në të dy llojet e komuniteteve, duhet bërë identifikimi dhe konsultimi me influencuesit kyçë, në nivel komuniteti, për kryerjen e vlerësimeve vendore, të cilat do të informojnë programimin për PEDH. Plotësimi i qasjeve nga lart-poshtë me qasjet nga poshtë-lart duke bashkëpunuar për zhvillimin e veprimtarive për PEDH-në me institucionet vendore, të cilat do të lejojnë programim më të kontekstualizuar, si dhe do të rrisin ndërgjegjësimin dhe pranueshmërinë vendore.*
- ≡ *Përfshirja e formave të ekstremizmit etniko-nacionalist dhe të ekstremit të djathtë, që po marrin gjithnjë e më tepër vëmendje në ligjërimit, strategjitë dhe planet e veprimit për parandalimin dhe luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Kjo do të ndihmonte në adresimin e “islamizimit” kundër-produktiv të ekstremizmit të dhunshëm dhe në sigurimin e angazhimit të aktorëve që mund të ndjehen të veçuar ose të stigmatizuar në mënyrë të padrejtë.*

### Donatorët, OJF-të dhe agjencitë qeveritare ndërkombëtare

- ≡ *Sigurimi që programimi i ri për PEDH të bazohet në parimet e shëndosha të vendosjes së paqes dhe parimet e ndjeshmërisë ndaj konfliktit dhe që programimi për PEDH të “ushqehet” nga mësimet e nxjerra nga puna e mëparshme për vendosjen e paqes. Nxjerrja e këtyre mësimëve duhet të përfshijë përsosjen e metodologjive të monitorimit dhe vlerësimit specifik për PEDH, për të vlerësuar në mënyrë më sistematike efektshmërinë dhe ndikimin e programimit për PEDH.*
- ≡ *Investimi në programe që janë të përshtatura dhe të personalizuara për nevojat e çdo lokaliteti. Programet nuk duhet të kopjohen pa vlerësuar kontekstin specifik të komunitetit. Ky projektim duhet të përfshijë përfaqësuesit vendorë që sjellin perspektiva të ndryshme.*

## Referenca dhe material për lexim

**Aroua, Abbas** 2018. Addressing Extremism and Violence. The Importance of Terminology. Geneva: The Cordoba Foundation of Geneva. [https://www.cordoue.ch/images/pdf/Papers/CFG\\_ConflictTransformationPerspective.pdf](https://www.cordoue.ch/images/pdf/Papers/CFG_ConflictTransformationPerspective.pdf)

**Austin, Beatrix & Hans J. Giessmann** (eds.) 2018. Transformative Approaches to Violent Extremism. 2018. *Handbook Dialogue Series No. 13*. Berlin: Berghof Foundation. [https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Handbook/Dialogues/dialogue13\\_violent\\_extremism\\_complete.pdf](https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Handbook/Dialogues/dialogue13_violent_extremism_complete.pdf)

**Ellis, B. Heidi & Saida Abdi** 2017. Building Community Resilience to Violent Extremism through Genuine Partnerships. In: *American Psychologist*, Vol. 72, No. 3, 289–300.

**Fischer, Astrid & Engjellushe Morina** 2019. Preventing Violence, in Berghof Glossary on Conflict Transformation and Peacebuilding, Berlin: Berghof Foundation, 123-129. [https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Books/Book\\_Glossary\\_Chapters\\_en/berghof\\_glossary\\_2019\\_preventing\\_violence.pdf](https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Books/Book_Glossary_Chapters_en/berghof_glossary_2019_preventing_violence.pdf).

**Holdaway, L. & Simpson, R.** 2018. Improving the Impact of Preventing Violent Extremism Programming: A Toolkit for Design, Monitoring & Evaluation. New York & London: UNDP & International Alert. <https://www.international-alert.org/publications/preventing-violent-extremism-toolkit>

**Jakupi, Rudine & Garentina Kraja** 2018. Accounting for the Difference: Vulnerability and Resilience to Violent Extremism in Kosovo. Country Case Study 3. Berlin/Prishtina: Berghof Foundation and Kosovar Centre for Security Studies (KCSS), 2018. [https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other\\_Resources/WB\\_PVE/CTR\\_CaseStudy3Kosovo\\_e.pdf](https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other_Resources/WB_PVE/CTR_CaseStudy3Kosovo_e.pdf)

**Morina, Engjellushe, Beatrix Austin, Tim Jan Roetman & Véronique Dudouet** 2019. Community Perspectives on Preventing Violent Extremism Lessons learned from the Western Balkans. Research Report. 2019. [https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other\\_Resources/WB\\_PVE/CTR\\_PVE\\_WesternBalkans\\_Research\\_Report.pdf](https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other_Resources/WB_PVE/CTR_PVE_WesternBalkans_Research_Report.pdf)

**Qirjazi, Redion & Romario Shehu** 2018. Community Perspectives on Preventing Violent Extremism in Albania. Country Case Study 4. Berlin/Tirana: Berghof Foundation and Institute for Democracy and Mediation (IDM), 2018. [https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other\\_Resources/WB\\_PVE/CTR\\_CaseStudy4\\_Albania\\_e.pdf](https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other_Resources/WB_PVE/CTR_CaseStudy4_Albania_e.pdf)

**Search for Common Ground (SfCG)** 2017. Transforming Violent Extremism. A Peacebuilder's Guide. Washington DC: SfCG. <https://www.sfcg.org/wp-content/uploads/2017/04/Transforming-Violent-Extremism-V2-August-2017.pdf>

**Shtuni, Adrian** 2016. Dynamics of Radicalization and Violent Extremism in Kosovo. Special Report 397. Washington, DC: United States Institute of Peace. [www.usip.org/sites/default/files/SR397-Dynamics-of-Radicalization-and-Violent-Extremism-in-Kosovo.pdf](http://www.usip.org/sites/default/files/SR397-Dynamics-of-Radicalization-and-Violent-Extremism-in-Kosovo.pdf)

**Stojkovski, Filip & Natasia Kalajdziovski** 2018. Community Perspectives on Preventing Violent Extremism in Macedonia. Country Case Study 1. Berlin/Skopje: Berghof Foundation and Democracy Lab, 2018. [https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other\\_Resources/WB\\_PVE/CTR\\_CaseStudy2BiH\\_e.pdf](https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other_Resources/WB_PVE/CTR_CaseStudy2BiH_e.pdf)

**Turcalo, Sead & Nejra Veljan** 2018. Community Perspectives on Preventing Violent Extremism in Bosnia-Herzegovina. Country Case Study 2. Berlin/Sarajevo: Berghof Foundation and Atlantic Initiative, 2018. [https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other\\_Resources/WB\\_PVE/CTR\\_CaseStudy1\\_Macedonia\\_e.pdf](https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other_Resources/WB_PVE/CTR_CaseStudy1_Macedonia_e.pdf)

### Rreth Autorëve

**Engjellushe Morina** anëtare e Programit Kërkimor për Transformimin e Konfliktit (CTR) në Fondacionin Berghof. Ajo ka zhvilluar dhe bashkëudhëhequr një sërë projektsh kërkimore mbi Mundësitë e Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor. Ajo ka drejtuar një sërë projektsh dhe kohët e fundit ka menaxhuar edhe Projektin e Dialogimit të Nivelit 1.5 në Maqedoni. Znj. Engjellushe ka mbi gjashtëmbëdhjetë vjet përvojë pune me orientim praktik dhe kërkimor në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit, si dhe në MB, Egjipt, Itali, Ukrainë dhe Kirgistan.

**Beatrix Austin** është Drejtoresha e komanduar e Programit CTR të Fondacionit Berghof (prill-tetor 2019). Ajo bashkëredakton dhe koordinon Manualin për Transformimin e Konfliktit në Fondacionin Berghof, menaxhon një sërë projektsh botimi dhe është përfshirë në projekte kërkimore bashkëpunuese lidhur me mundësitë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor. Si studiuese, ajo interesohet veçanërisht për ndërthurjen e teorisë dhe praktikës në fushën e transformimit të konfliktit, si dhe në çështjet e lidhura me trajtimin e rasteve në të kaluarën.

**Tim Jan Roetman** është oficer projekti në programin CTR të Fondacionit Berghof. Aktualisht, Tim Jan po punon me një projekt për rolin e anëtareve të Grupeve të Armatosura Joqeveritare në negociatat për paqe dhe lidhshëm pas luftës. Tim Jan ka përvojë të mëparshme edhe në zbatimin e projekteve zhvillimore në arsim dhe pajtim në Francë dhe Ballkanin Perëndimor.

**Dr. Véronique Dudouet**, është Drejtoreshë e Programit për CTR-në në Fondacionin Berghof, e cila është me leje sabatike në USIP, Washington, DC që nga muaji prill deri në tetor të vitit 2019. Ajo koordinon projekte të ndryshme kërkimore bashkëpunuese për rolin e grupeve të armatosura joqeveritare, lëvizjet sociale, dhe aktorët ndërkombëtarë në proceset e transformimit të konfliktit. Ajo kryen rregullisht hulumtime konsulence, si dhe jep këshillim mbi politikën, këshillim, si dhe seminare trajnimi për/me aktorët e interesit në çështjet e konfliktit dhe vendosjes së paqes. Ajo është bashkëautore e dy librave dhe është autore e një sërë botimesh të tjera në fushën e transformimit të konfliktit dhe rezistencës jo të dhunshme.